



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

MENDIM NË PAKICE

Mbi votimin “KUNDËR” ndaj qëndrimit të shumicës për pikën 2 të Vendimit nr. 235, datë 02.07.2020 për *“Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 85 dhe nr.86, datë 26.02.2020”*.

Në Mbledhjen Plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, **datë 02.07.2020** në pikën e dhjetë të rendit të ditës, është përfshirë për shqyrtim në këtë mbledhje projektvendimi “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidatës znj. {...}” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Për sa më sipër, nisur nga fakti që kam mbajtur qëndrim të kundërt me shumicën e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe bazuar në nenin 66 pikën 9, të ligjit 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit Të Drejtësisë”...

Thirrja e mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor...

...9. Në rastet kur Këshilli merr vendime administrative individuale në lidhje me statusin profesional të gjyqtarëve të veçantë ose të zyrtarëve të veçantë të administratës gjyqësore, anëtari i mbetur në pakicë mund të kërkojë që opinioni i tij t’i bashkëngjitet vendimit të Këshillit. Në këtë rast, anëtari është përgjegjës për hartimin dhe dorëzimin e opinionit të pakicës brenda afatit të caktuar nga Këshilli për zbardhjen e vendimit...., parashtrijmë sa më poshtë argumentet tona, në lidhje me këtë çështje:

- Për sa i përket aspektit formal procedural më duhet të theksoj se;

Në nenin 47 pika 5 e ligjit parashikohet se “Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë Gjykatës së Lartë ..., ***nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar***”.

Siç kam theksuar në Relacion rezulton se nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 85 dhe nr. 86 datë 26.02.2020, të këtë përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile, si gjyqtare e shkallës së parë, 3 vjet e 6 muaj e 21 ditë, si dhe si ndihmësgjyqtare për 4 vjet e 8 muaj.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale, nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit evidentohet se ajo plotësohet vetëm nëse merren në konsideratë përvoja/gjykimet në fushën e të drejtës civile dhe penale me cilësinë e anëtarit të trupit gjykues si ndihmësgjyqtare.

Nga interpretimi i dispozitave Kushtetuese si edhe ligjeve në zbatim të saj rezulton se e vetmja kategori e përzgjedhur nga sistemi gjyqësorë për tu emëruar në Gjykatën e Lartë është ajo me përkatësi magjistratë profili "**GJYQTARE**" (neni 136 i Kushtetutës). Më konkretisht në këtë nenë përcaktohet se "*Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit*", duke parashikuar minimumin e viteve të përvojës si magjistratë, **me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit.** Më tej ligjvënësi në nenin 48 të Ligjit nr.96/2016 "*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*" parashikon një sistem rregullash jo vetëm për vlerësimin individual të tyre por edhe për ngritjen në detyrë e cila konsiderohet ndër të tjera si "*...omissis.. kalimi nga një pozicion në sistemin gjyqësor..., në një pozicion tjetër të një niveli më të lartë*", duke përfshirë në të edhe emërimin në Gjykatën e Lartë.

Nga interpretimi i nenit të sipërcituar rezulton se ligjvënësi me përdorimin e shprehjes "*magjistrati.. omissis.. nëse ka ushtruar funksionin...*" indikatorin e përvojës specifike e ka lidhur me ushtrimin e funksionit të magjistratit (gjyqtarit) duke përfshirë përfshirjen e kategorive të tjera të cilat kanë gëzuar një status të ngjashëm por jo të barabartë me gjyqtarin jo vetëm nga pikëpamja formale e emërimit /Dekret të Presidentit, kontratës së punës (pagës) por edhe të drejtave dhe detyrimeve gjatë gjyqimeve procedurale civile apo penale.

Nga pikëpamja formale ligjvënësi në përcaktimin e tij duke vendosur për efekt të përzgjedhjes në mënyrë të shprehur qartë, *in claris non fit interpretatio*, kategorinë e subjektit për tu promovuar magjistrat/gjyqtare, si edhe kritere të mire përcaktuara për tu plotësuar, ka synuar të evitojë keqinterpretime në identifikimin e subjekteve të cilat do të duhet të përzgjidhen nga kategoria e gjyqtareve.

Natyrisht më parë ligjvënësi për efekt të politikave të rekrutimit kur ka dashur të përcaktojë kategori të posaçme të subjekteve të ngjashme me gjyqtarin si p.sh. "ndihmës gjyqtarin" ka vendosur në legjislacion me anë të së cilës organizonte drejtësinë, (Ligji nr.7574. datë 24.6.1992 "Për Organizimin e Drejtësisë dhe disa ndryshime në Kodet e Procedurave Penale e Civile" me ndryshime, Ligji nr.8265, date 18.12.1997 "Për Organizimin e Drejtësisë në Republikën e Shqipërisë" me ndryshime; Ligji nr.8436, date 28.12.1998 "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor" me ndryshime), përfshirte apo terma të cilat lejonin përfshirjen e tyre në rekrutim në nivele të ndryshme të gjyqësorit.

Sjell në vëmendjen tuaj se në ndryshim nga ndihmësgjyqtarët popullorë, të cilët sipas nenit 18 të ligjit nr. 4406, dt. 24 Qershor 1968 "Mbi organizimin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" "...ndihmonin në lidhjen e gjykatës me masat, ... në mobilizimin e punonjësve për mënjanimin e shkaqeve të shkeljeve dhe në popullarizimin e ligjeve dhe të vendimeve gjyqësore", me Ligjin nr.7574. datë 24.6.1992 "Për Organizimin e Drejtësisë dhe disa ndryshime në Kodet e Procedurave Penale e Civile" ndihmesat duhet të mbaronin Fakultetin Juridik dhe emëroheshin me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Më pas me Ligjin nr.8546, datë 05.11.1999 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.8436, datë 28.12.1998 'Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë' kjo figure u suprimua dhe për efekt rekrutimi u parashikua mundësia e emërimit të tyre si gjyqtar. Përfundimisht me ligjet nr. 8601, datë 10.04.2000 "Për një ndryshim në Kodin e Procedurës Civile të

Republikës së Shqipërisë” dhe nr. 8602, datë 10.04.2000 “Për një ndryshim në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë kjo kategori e gjyqësorit u suprimua përfundimisht nga pjesëmarrja në trupa gjyqësore.

Në kushtet kur znj. **përvojën/gjykimet specifike në fushën e të drejtës civile dhe penale i plotëson me cilësinë e anëtarit të trupit gjyqësor si ndihmësgjyqtare, e cila nuk përfshihet në subjektet e përcaktuara** në nenin 47 pika 5 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” jam kundër vijimit të procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për shkak se kandidatës në bazë të Vendimit 75/2019 mbështetur në shkronjën “a”, pika 12, Seksioni B, Kreu VI, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të gjykatës së lartë”, duhej të komunikoheshin evidentimi i fakteve dhe shkakut ligjor i cili e pengon atë në lidhje me kandidimin e saj, duke i dhënë asaj mundësi argumentimi/ mbrojtje të gjetjes në procedurë.

Për sa më sipër, shprehim qëndrimin dhe argumentet tona dhe votuam **“KUNDËR”**

**Anëtari
Alban Toro**